



Newsletter, KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1 Janar – Prill, 2021

Index:

Aktivitet	2
Aktivitet	6
Deklaratë	10
Deklatatë	16

KMD DHE KQZ REKOMANDIME TË PËRBASHKËTA PËR SUBJEKTET POLITIKE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJE




Në kuadër të përgatitjeve të zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit 2021 dhe respektimit të detyrimeve Kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me datë 25 janar kanë nënshkruar një dokument me disa Rekomandime të përbashkëta për subjektet politike pjesëmarrëse në fushatën elektorale.

Rekomandimet kryesore synojnë ndërgjegjësimin e subjekteve politike dhe administratës zgjedhore mbi:

- Respektimin e parimit të barazisë;
- Ndalimin e diskriminimit
- Parandalimin e gjuhës së urrejtjes
- Adresimin e temave të ndjeshëm
- Përfaqësimin e barabartë të listat zgjedhore
- Respektimin e kuotave gjinore në listat e subjekteve zgjedhore

Këto Rekomandime janë në përputhje me nëntë Konventat të të Drejtave Themelore të OKB, KiE, vlerat e përcaktuara në traktatet e BE, parimet themelore të OSBE, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit zgjedhor. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë të gatshëm të ofrojnë asistencë në shtjellimin e këtyre Rekomandimeve.

KMD intervistë mbi diskriminimin në Punë

Në Shqipëri, përpjekjet e punonjësve për t'u organizuar në një sindikatë ndëshkohen me heqje nga puna. Kjo ka bërë që një pjesë e madhe e tyre t'i drejtohen Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në një intervistë për MCN TV, kreu i këtij institucioni, Robert Gajda, thotë se dy sektorët me numrin më të madh të ankesave për largim nga puna për këtë shkak janë call centerat dhe minierat.

"Sektorët kryesisht kanë qenë Call Center. Por edhe në sektorin minerar kemi pasur raste. Por kryesisht kanë qenë të fokusuar në Call Center. Natyra e çështjeve është e dylllojshme. Kemi pasur raste kur njerëzit janë hequr nga puna duke qenë në sindikatë, por kemi pasur edhe raste kur njerëzit janë hequr nga puna sapo kanë filluar procedurat për të hapur një sindikatë", thotë ai.

Në krahasim me vitin e kaluar, ka një rritje të ankesave nga punonjës që kanë tentuar të krijojnë sindikata. Gajda thotë se për shkak të hapësirave që lë Kodi i Punës, më të predispozuar për t'u larguar nga puna janë punonjësit që përpiqen të krijojnë një sindikatë sesa ata që janë bërë pjesë e saj.

"Në këto raste, duke u bazuar në Kodin e Punës, ne kemi krijuar një mbrojtje për punonjësit, të cilët hidhen për të krijuar sindikata. Kodi i Punës mbron shumë anëtarësinë e sindikatës, kur ajo është krijuar, por është pak më i heshtur për pjesën para se të krijohet sindikata", shprehet Gajda.

Të futura në treg në 15 vitet e fundit, Call Centerat kanë aktualisht rreth 25 mijë të punësuar, mbi 3/4 e të cilëve janë deri 30 vjeç. Ndërsa sektori minerar, ndër më të rëndësishmit nga pikëpamja ekonomike, mbetet sektori me numrin më të madh të punonjësve që kanë humbur jetën në punë gjatë 10 viteve të fundit.

Reagim për problematikën në shkollën "Europa", në Bradashesh

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda iu përgjigj interesimit të medias për protestën e prindërve në shkollën "Europa" në Bradashesh, Elbasan, për mungesën e shërbimit të ngrohjes.

Komisioneri Dr. Gajda u shpreh se u njoh nga mediat për ngjarjen dhe Institucioni i KMD do të nisë një hetim kryesisht (ex-officio) për këtë problematikë, duke verifikuar situatën dhe për rrjedhojë marrjen e masave që parashikon ligji.



Komisioneri Gajda takim me Komisionerin e Zgjedhje, Celibashi



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda zhvilloi një takim me datë 12 janar me z. Ilirian Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Në këtë takim Komisioneri Dr. Gajda bisedoi për parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe i diskriminimit gjatë fushatës zgjedhore të pritshme, si dhe nevojën për aksesin në informacion, krijimin e kushteve të përshtatura në personat me aftësi ndryshe, sipas llojit të kufizimit të aftësisë.

Nga ana e tij, kreu i KQZ z. Celibashi vlerësoi interesimin e KMD për gjithëpërfshirjen e grupeve vulnerabël në procesin zgjedhor dhe nevojën për shmangien e gjuhës së urrejtjes mes subjekteve politike. Komisioneri Celibashi pasi e njohu Gajda me ecurinë e procesit të implementimit të teknologjisë në zgjedhje dhe votimin nga jashtë të shtetasve shqiptarë, garantoj se për Personat me Aftësi të Kufizuara ashtu si në zgjedhjet e shkuara, KQZ në fushatën e saj edukuese do të përfshijë gjuhën

e shenjave për zgjedhësit që nuk dëgjojnë, ndërsa qendrat e votimit do të pajisen me shabllonë me alfabetin 'Braille' për zgjedhësit që nuk shikojnë.

Të dyja palët dakordësuan miratimin e përbashkët dhe publikimin e një rekomandimi për të parandaluar përdorimin e gjuhës së urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore si edhe një akt të përbashkët për respektimin e kuotës gjinore.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke falenderuar z. Celibashi për mbështetjen e ofruar për promovimin e parimit të mosdiskriminimit, të barazisë dhe të tolerancës, shprehu gadishmërinë për të bashkërenduar punën institucionale me fokus trajtimin e problematikave të zgjedhësve me aftësi ndryshe në zgjedhjet e datës 25 prill 2021.

"Ditët e Hapura Kundër Diskriminimit"

Përfaqësuesja e zyrës Rajonale KMD Fier, znj. Aidana Hyka në kuadër të nismës "Ditët e Hapura Kundër Diskriminimit" këtë herë ishte në qytetin e Lushnjes, në të cilin u shpërndanë fletpalosje dhe kopje të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të rritur ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e qytetarëve, në mënyrë që të referojnë ç'do lloj forme të diskriminimit!



COVID-19 shtoi izolimin dhe varfërinë e personave me aftësi të kufizuar



Një raport i publikuar nga organizata 'Together for Life' me mbështetjen e Fondacionit Westminster për Demokraci zbulon se personat me aftësi të kufizuar janë përballur me problematika shtesë gjatë pandemisë së Covid-19, veçanërisht gjatë periudhës së karantinës së detyruar nga masat kufizuese të ndërmarra nga qeveria gjatë pranverës së vitit 2020..

Sipas këtij raporti që mbulon gjashtë qarqe, i titulluar "Ndikimi i Covid-19 te Personat me Aftësi të Kufizuara," 8 në 10 persona me aftësi të kufizuara kanë përjetuar probleme financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pandemia e COVID-19.

"Një ndër problematikat që evidentuam gjatë monitorimit ishte pamundësia për të lëvizur e ndihmës personal të personit që kishte nevojë për asistencë dhe izolimi i të dyve," shpjegoi Darian Konomi, Specialist i Monitorimit dhe Raportimit tek Komisioneri për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit.

"Të pamundur të lëviznin e kishin edhe personat që jetonin vetëm," theksoi ai, ndërsa shtoi se personat që kishin nevojë për ndihmës personal nuk morën asnjë udhëzim se çfarë protokolli duhej të ndiqte ky i fundit.

Sipas Konomit, një tjetër problem gjatë kësaj periudhe për personat me aftësi të kufizuar, në mënyrë të veçantë për persona me aftësi të kufizuar intelektuale, ishte mungesa e qasjes në shërbime sociale e rehabilituese të ofruara më parë në qendra komunitare ditore ose rezidenciale.

"Aftësia e kufizuar intelektuale pati probleme shumë të mëdha," tha Konomi. "Kemi patur sjellje devijante si mbyllje në vetvete, apo edhe sjellje të dhunshme në disa raste," shtoi ai.

Sipas raportit të TFL-së, situata e krijuar nga pandemia e COVID-19 dhe kufizimet e vendosura nga qeveria për parandalimin e saj, çuan në uljen drastike të numrit të personave me aftësi të kufizuar që trajtoheshin në qendrat rezidenciale, ditore dhe komunitare. Ndërkohë që shumica e personave me aftësi të kufizuar gjatë periudhës së karantinës u trajtuan në shtëpitë e tyre, rreth 15% e të anketuarave deklaruan se u detyruan ta ndërprisnin trajtimin gjatë kësaj periudhe.

Kastriot Sulka, ekspert i çështjeve sociale dhe punësimit, tha se shoqëria po përballët me vështirësi për t'i ndihmuar dhe mbështetur shtresat më në nevojë gjatë periudhës së pandemisë.

"Pandemia që shkaktoi COVID-19 ka nxjerrë në dukje dobësinë e sistemeve të ngritura deri tani dhe në të njëjtën kohë, edhe vlerave njerëzore të shoqërisë," tha Sulka/BIRN

KMD Gajda takim me subjektin politik LSI



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda zhvilloi një takim me datë 19 janar me znj. Monika Kryemadhi, Kryetare e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

Në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të pritshme të 25 prillit, Komisioneri Dr. Gajda bisedoi për rëndësinë e përfaqësimit të grupeve vulnerabël, respektimin e kuotave gjinore në listat për deputetë, shmangien e gjuhës së urrejtjes dhe promovimin e barazisë.

Nga ana e saj, kryetarja e LSI znj. Kryemadhi theksoi se parti saj është e angazhuar plotësisht, që të mbështesë punën e këtij institucioni në përmbushje të misionit të tij.

Temë diskutimi ishte edhe ndalimi i diskriminimit nga partitë politike dhe kandidatët, si dhe njerëzit që punojnë për ta, që duhet të refuzojnë, në programet dhe fushatat e tyre, të përdorin gjuhë diskriminuese ose të propozojnë politika dhe ligje diskriminuese, të shprehin ose mbështesin ide apo teori të superioritetit të një grupi personash bazuar në racën, origjinën etnike, fenë, gjininë, moshën, orientimin seksual, identitetin gjinor, aftësinë e kufizuar si edhe karakteristika të tjera personale të mbrojtura apo një kombinim të tyre.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do

të zhvillojë takime me krerët e partive politike për të folur rreth rëndësisë së masave konkrete të sugjeruara në Rekomandimit Nr. 15 të ECRI-t në lidhje me luftën kundër gjuhës së urrejtjes duke i vënë theksin konsolidimit të kornizës ligjore dhe institucionale në luftën kundër gjuhës së urrejtjes, me qëllim ndëshkimin e këtyre rasteve.

KMD takim Kryetarin e Prezencës së OSBE në Shqipëri

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në një takim Kryetarin e Prezencës së OSBE në Shqipëri, z. Vincenzo Del Monaco.

Komisioneri Dr. Gajda e informoi ambasadorin Del Monaco për veprimtarinë e KMD dhe vlerësoi bashkëpunimin me OSBE për projekte të përbashkëta.

Nga ana e tij, Ambasadori Del Monaco falënderoi institucionin e KMD për punën më shërbim të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe promovimin e barazisë.

Komisioneri Dr. Gajda vuri në dukje se institucioni i KMD po angazhohet para zgjedhjeve parlamentare me subjektet politike për një kujdes të veçantë për grupet vulnerabël dhe shmangien e gjuhës së urrejtjes gjatë



“Të drejtat e grave punonjëse në fabrikat “fason”, Covid 19 dhe perspektiva për vitin 2021”.



Përfaqësues të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi po marrin pjesë në Tryezën Kombëtare të Diskutimit: “Të drejtat e grave punonjëse në fabrikat “fason”, Covid 19 dhe perspektiva për vitin 2021”.

Ky aktivitet organizohet nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” në kuadër të projektit “Të drejtat e grave në tregun e punës”.

Në këtë tryezë po diskutohet në lidhje me impaktin që pandemia #COVID-19 ka shkaktuar gjatë periudhës së mbylljes dhe në muajt në vazhdim në kompanitë #fason.

Qendrueshmëria dhe siguria e vendit të punës të grave dhe vajzave, mirëqenia ekonomike, dhe perspektiva për vitin 2021 po diskutohen nga aktorë të ndryshëm përfshirë, përfaqësues të Qeverisë, biznesit “fason”, përfaqësues nga Parlamenti i Shqipërisë, institucionet publike si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, donatorë që operojnë në Shqipëri dhe organizata të shoqërisë civile.

Diskutimi do të fokusohet edhe në rekomandime se si mund të kontribuohet për ti paraprirë dhe për t’ju përgjigjur krizës aktuale dhe nevojave të së ardhmes për punësim të denjë.

KMD Gajda takim me ambasadorin e Republikës së Francë në Shqipëri

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në një takim Ambasadorin e Republikës Franceze në Shqipëri, znj. Elisabeth Barsacq, shoqëruar nga atasheja për bashkëpunim, Anne Elisabeth Gautier-Budai.

Komisioneri Dr. Gajda e informoi ambasadorin për punën e institucionit, duke u ndaluar tek trendet e shkaqeve të diskriminimit në vend dhe masat që janë marrë për ndreqjen, sipas Ligjit të përmirësuar të KMD.

Nga ana e saj, ambasadorja Barsacq falënderoi komisionerin Dr. Gajda për informacionin dhe shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar më fusha të interesit të përbashkët.



Komisioneri Dr. Gajda mbi kriteret e pranimit në Policinë e Shtetit



Kush ka tatuazh në pjesët e dukshme të trupit nuk do të pranohet kurrë për t'u bërë pjesë e Policisë së Shtetit. Kështu parashikojnë ndryshimet më të fundit në rregulloren për policinë, të cilat kanë shtuar edhe tre kushte të tjera skualfikuese për aplikantët për t'u bërë pjesë të policisë.

Kushtet e reja përjashtuese janë evidentimi i tatuazheve, moskalimi i kontrollit mjekësor dhe mungesa e besueshmërisë.

Mirëpo, shumëkujt ky rregull i është dukur diskriminues. I ftuar në "Wake Up", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda theksoi se vendosja e kriterëve është domosdoshmëri në çdo punë, por duhet shpjeguar arsyeja e vërtetë pse është vendosur një kriter i caktuar.

"Impakti i parë paraqet probleme në vetvete, sepse është një kriter i vendosur rishtazi, i cili krijon dyshime për të pasur një hetim në lidhje me situatën dhe për të parë realisht këtë. Mbi të gjitha për të parë se cila është arsyeja, sepse në këto situata duhet të shohim cila është arsyeja dhe përse shërben ky kriter.

Vendosja e kriterëve në vetvete, në pamje të

parë nuk ka asnjë problem, sepse për çdo vend pune duhet të ketë kriteret. Ndërkohë, kur nuk ka një shpjegim të arsyeshëm për kriteret, duhet të themi nuk kuptohet", tha ai.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në takimin online të organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë për të ndarë mendime dhe sugjerime mbi projektligjin "Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Dr. Gajda vizitë pune në Kosovë

Avokati i Popullit të Kosovës, z. Naim Qelaj, ka pritur në takim të mërkurën, Avokaten e Popullit të Shqipërisë, znj. Erinda Ballanca me bashkëpunëtorë dhe Komisionerin për Mbrojtje nga Diskriminimi, z. Robert Gajda.

Znj. Ballanca dhe z. Gajda uruan z. Qelaj për marrjen e mandatit të Avokatit të Popullit të Kosovës dhe theksuan se janë të gatshëm që të vazhdojnë me punët e përbashkëta të nisura kohë më herët. Gjatë takimit palët po ashtu diskutuan edhe ndikimin e pandemisë Covid-19 në të drejtat e njeriut në Kosovë dhe Shqipëri dhe puna që është bërë nga të dyja institucionet në adresimin e ankesave të qytetarëve.



“Kostot e Demokracisë II; Paratë në politikë dhe Integriteti Zgjedhor”



Përfaqësuesja i zyres Rajonale të KMD Korçë znj. Etleva Tare mori pjesë në konferencën e organizuar nga Krik Albania me temë: “Kostot e Demokracisë II; Paratë në politikë dhe Integriteti Zgjedhor

Konferenca solli në tryezën e diskutimit aktorët më të rëndësishëm dhe kryesorë politikë e institucionalë si dhe përfaqësuesit më të rëndësishëm të trupit diplomatik në vend, për të diskutuar dhe paraqitur vullnetet e tyre politike mbi nevojën e Integritetit të Zgjedhjeve, me theks të veçantë në financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, si një nga aspektet kryesorë dhe më me ndikim në të, me synimin afatgjatë për të përfshirë rregullimin e kësaj veprimtarie në fokusin kryesor të reformës së pritshme zgjedhore, pas zgjedhjeve të ardhshme.

Qëllimi i kësaj konference ishte që të risjellë në vëmendje të aktorëve me interes, politikës, dhe publikut të gjerë nevojat për perspektivat të reja në adresimin e mangësive dhe problematikave mbi transparencën dhe mbikqyrjen efektive të

financave të partive dhe fushatave zgjedhore, si një përpjekje e mëtijshme dhe të vazhdueshme për t'i adresuar këto mangësi dhe problematika të pranuar gjerësisht, të para këto, veçanërisht, në raport me sigurimin e Integritetit të plotë të Zgjedhjeve.

"NE MUNDEMI-THUAJI JO DISKRIMINIMIT".

Në kuadër të "Javës kundër Diskriminimi", Zyra Rajonale e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Korçë, Zyra Rajonale e Avokatit të popullit Pogradec, dhe Zyra e Ndhmës Juridike Parësore Falas organizuan një takim me temë: "NE MUNDEMI-THUAJI JO DISKRIMINIMIT".

Ky takim u organizua me anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian dhe përfaqësues të OJF. Qëllimi i këtij takimi është ndërgjeshimi dhe informimi qytetar për ekzistencën e këtyre institucioneve të cilat vijnë në ndihmë të komunitetit



KMD bën bilancin për vendimet e institucionit për 2020



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda ishte i ftuar në emisionin "Për të Fol" në Tv Scan, për të biseduar rreth veprimtarisë së institucionit për vitin e kaluar dhe muajt e parë të 2021. Komisioneri Dr. Gajda vuri në dukje se në për vitin e kaluar KMD, pavarësisht situatës së pandemisë COVID, ka pasur 169 vendime.

Ndërsa ankesa pranë institucionit ka pasur një trend normal me vitet e kaluara (170 raste) dhe situata e diskriminimit në vend ka aspekte sfiduese për ekspozimin e tyre. Risia për ankesat ka të bëjë me faktin që qytetarët po ankohen më shumë për shërbimet e bashkive.

Ndryshimet ligjore në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë hapur mundësi të reja për ankesa e sensibilizim edhe nga organizatat e shoqërisë civile në disa qytete.

"Programi i Angazhimit Qytetar për Përparimin e të Drejtave të Komunitetit LGBTI në Shqipëri, Politika dhe Përfaqësimi".

Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale KMD Fier, znj. Aidana Hyka mori pjesë në takimin me temë: "Programi i Angazhimit Qytetar për Përparimin e të Drejtave të Komunitetit LGBTI në Shqipëri, Politika dhe Përfaqësimi".

Ky takim/trajnim u organizua nga Organizata Open Mind Spectrum Albania (OMSA), me mbështetjen e Republikës Federale të Gjermanisë, organizatë e cila po realizon një program me fokus angazhimin qytetar, të drejtat, përfaqësimin dhe politikat për promovimin e diversitetit dhe të barazisë në Shqipëri. Takimi i radhës ishte në Vlorë dhe Sarandë, me përfaqësues të Forumeve Rinore të Partive Politike në keto qytete, me pjesëmarrjen e Zyrës Rajonale të KMD-së në Fier si edhe Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit në Vlorë. Ky program synon të nxisë gjithëpërfshirjen brenda partive politike dhe të zbusë diskriminimin dhe stigmatizimin ndaj komunitetit LGBTI.



Transporti gjithpërfshirës një e drejtë universale!



Transporti është një e drejtë universale për të gjithë përfshi këtu edhe personat me aftësi të kufizuara. Duke parë problematikat institucionale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nisur një Bashkëpunim me Klubin e prindërve të fëmijëve me çrregullime të spektrit autik dhe Caritas Shqiptar duke mundësuar implementimin e një projekti pilot që synon të garantoi lëvizjen e lirë dhe të pa kushtëzuar të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Projekti zbatohet në kuadër të projektit SOCIETES 2 me fonde të Bashkimit Evropian

Projekti do të pilotohet në Tiranë dhe fillimisht do të ketë 20 përfutues me aftësi të kufizuara. Parashikohen trajnime për ofruesit e shërbimit si dhe ngritja e një rrjeti vullnetarësh që do të asistoi përgjatë gjithë periudhës së implementimit të projektit. Çdo ndryshim nis nga mendësia e duhur, KMD beson se sinergji të këtilla duhet të intensifikohen. Bashkëpunimi i të gjithë faktorëve përgjegjës mund të sjell ndryshim.

KMD dëshiron të falënderoj Organizatat Klubi Kombëtar i Prindërve me Çrregullime të Spektrit autik dhe Caritas Shqiptar për frymën e bashkëpunimit dhe uron që projekti “Transporti Gjithpërfshirës” të përbëj hapin e parë për një model të qëndrueshëm që do të mundësoi

lëvizje të pa kushtëzuar për personat me aftësi të kufizuara.

KMD falënderon gjithashtu përfaqësuesit e unionit të transportit dhe Ministrinë e Shëndetësisë, pjesëmarrëse në takim. Të gjithë së bashku mundemi ,sepse kur lëviz jetoj, kur jetoj kontribuoj.

DHUNA NDAJ GRUAS—REAGON KMD

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u njoh përmes portalit JOQ Albania me një ngjarje të rënde të ndodhur në ambientet e jashtme të spitalit të Fierit, ku një grua u dhunua barbarisht.

KMD nxit policinë e Fierit dhe Prokurorinë e rrethit gjyqsor Fier që të nisin hetimet, të ndalojnë dhunuesin dhe të zbatojnë rigorozisht legjislacionin penal.

Ngjarjet e dhunshme ndaj gruas, janë të papranueshme dhe duhet të jenë të dënueshme në një shoqëri që pretendon respektim të dinjitetit njerëzor.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi fton të gjithë personat që ndjehen të dhunuar dhe diskriminuar të raportojnë rastet e tyre. Ligji ju mbron.



KMD Gajda leksion në Akademinë e Integritit European dhe Negociatave



Akademia e Integritit European dhe Negociatave po zhvillon një sërë trajnimesh për rritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe administratës në kuadër të çeljes së negociatave me BE. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda ishte i ftuar të trajtonte detyrimet e Shqipërisë për mbrojtjen ndaj diskriminimit, kuadrin e minoriteteve, si edhe sfidat e perspektivat e Shqipërisë në përmbushje të kërkesave të Kapitullit 23.

KMD Gajda në Ceremoninë e Prezantimit të Rrjetit të Mësuesve

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në Ceremoninë e Prezantimit të Rrjetit të Mësuesve (#TeacherNet) në shkollën 9-vjeçare "Abdyl Paralloi" Elbasan, organizuar në prag të 7 Marsit dhe në kuadër të projektit të Këshillit të Europës "Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri", financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (#SIDA).

“Sfido Urrejtjen-Menaxhimi i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit”

Sot më datë 11 Mars 2021, ora 11:00 pranë ambienteve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) u organizua takimi midis QBNF-së të përfaqësuar nga kryetari i QBNF Dr. Arben Ramkaj dhe drejtori ekzekutiv Sokol Lulgjuraj dhe KMD-së me prezencën e Komisionerit z. Robert Gajda.

Qellimi i takimit ishte vendosja e bashkëpunimit për implementimin e projektit me teme: “Sfido Urrejtjen-Menaxhimi i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit” i cili financohet nga Autoritetit i Mediave Audiovizive (AMA).

Gjate takimit dolën në pah shume problematika dhe ceshtje të lidhura me gjuhen e urrejtjes me sfond fetar.

Ky bashkëpunim AMA-KMD-QBNF, do të vendosi baza të forta për vazhdimësinë dhe bërjen traditë me qëllim përmirësimin e problemit në fjalë.



Aleanca pa Urrejtje reagon për gjuhën e urrejtjes të përdorur gjatë fushatës zgjedhore



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, edhe në kuadër të Aleancës pa Urrejtje, po monitoron çdo ditë fushatën elektorale të subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit.

Ditët e fundit, Institucioni i KMD konstaton me keqardhje një përshkallëzim të retorikës politike, që herë pas herë, kalon kufijtë e gjuhës së urrejtjes dhe etiketimeve denigruese ndaj gruas, minoriteteve.

Sot institucioni i KMD u njoh edhe me një reagim të disa organizata të Shoqërisë civile, të cilat i përshëndet dhe i mbështet në aksionin e tyre për të denoncuar, ndërgjegjësuar dhe promovuar të drejtat e Njeriut në vend.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shënon çdo ditë rastet duke mbajtur një raport të detajuar të ngjarjeve dhe personave të përfshirë.

Institucioni i KMD kërkon nga subjektet politike

të vetpërmbahen dhe të mos përdorin gjuhë urrejtje në fushatë, si dhe të respektojnë Rekomandimet publike të ECRI nr.15 mbi gjuhën e urrejtjes, rekomandimin e EQUINET për fushatat zgjedhore dhe rekomandimin e përbashkët KQZ-KMD dërguar partive politike.

“Mbështetje për ofrimin e ndihmës juridike parësore, efektive dhe cilësore për individët dhe komunitetet e marginalizuara në rajonin e Durrësit”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në takimin e rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Durrës, ku diskutuam mbi risitë e Ligjit nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010 ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’” dhe mundësitë për bashkëpunim në kuadrin e zbatimit të këtij ligji.

Aktiviteti u organizua në kuadrin e projektit “Mbështetje për ofrimin e ndihmës juridike parësore, efektive dhe cilësore për individët dhe komunitetet e marginalizuara në rajonin e Durrësit”, i cili po zbatohet nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).



“Për drejtësi më të aksesueshme për gratë dhe burrat në Shqipëri”



Projekti “Për drejtësi më të aksesueshme për gratë dhe burrat në Shqipëri”, i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) dhe mundësohet me fonde nga Ambasada Norvegjeze në Shqipëri.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shpjegon se miratimi i ligjit të vitit 2015 ishte një reflektim në kuadër të shtetit social, me qenë se energjia elektrike është një shërbim esencial dhe në rastin e familjeve me probleme ekonomike ajo duhet paguar nga qeveria.

“Kjo krijon probleme sociale të mëdha sepse familjet ose futen në borxhe për të paguar një shërbim esencial, siç është energjia ose do të rrinë pa drita, që i kthen pas si në mesjetë dhe sidomos në kohë pandemie, paragjykon familjet e pamundura ekonomikisht”, analizon Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda.

Prej kohësh parlamenti i Shqipërisë ka miratuar një ligj për perfitimin e energjisë elektrike dhe

disa lehtësira të cilat duhet të garantohen disa grupeve shoqërore që janë të pamundur ekonomikisht për të përballuar energjinë elektrike. Zbatimi i këtij ligji kërkon nxjerrjen e një akti nenligjor nga disa ministri.

KMD takim në Vlorë me organizatat e shoqërisë civile në terren,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda zhvilloi një takim në Vlorë me organizatat e shoqërisë civile në terren, zyrën e Avokatit të Popullit dhe Autoritet vendore të qarkut Vlorë për të shpjeguar risitë e ndryshimeve në ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku parashikohet tashmë më shumë të drejta të garantuara për grupet vulnerabël dhe promovimin e barazisë.



KMD Shkodër së bashku me ofuesit të shërbimit ligjor falas dhe Qendres për Nisma Ligjore Qytetare



Robert Gajda, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ishte në Shkodër së bashku me ofuesit të shërbimit ligjor falas dhe Qendres për Nisma Ligjore Qytetare për të diskutuar mbi risitë e Ligjit nr. 124/2020 PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10221, DATË 4.2.2010 “PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI” dhe mundësitë për bashkëpunim në kuadrin e zbatimit të këtij ligji.

Disa nga çështjet që u diskutuan ishin:

- “Diskriminim”; “Diskriminim i drejtpërdrejtë”; “Diskriminim ndërsektorial”; “Diskriminim për shkak të shoqërim”; “Diskriminim i shumëfishtë”; “Diskriminim strukturor”; “Diskriminim i tërthortë”; “Gjuha e urrejtjes”; “Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme”; “Nxitja ose ndihma për diskriminim”; “Organizatat me interesa legjitime”; “Qëllimi i shpallur për diskriminim”; “Shqetësim seksual”; “Udhëzim për të diskriminuar”; “Veçimi”; “Viktimizimi”; Format e rënda të diskriminimit;
- Barra e provës;
- Ankimi i Vendimit të KMD;
- Ekzekutimi i gjobave dhe vendimeve të

Komisionerit;

- Procedurat para gjykatës;
- Roli i OJF-ve në zbatim të këtij ligji;

Ky aktivitet u organizua në kuadrin e projektit “Mbështetje për ofrimin e ndihmës juridike parësore, efektive dhe cilësore për individët dhe komunitetet e marginalizuara në rajonin e Shkodrës”, i cili po zbatohet me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).


Aleanca Pa Urrejtje takim me përfaqësues të subjekteve politike

Aleanca Kundër Gjuhës së Urrejtjes (AKGJU) së bashku me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe përfaqësues të Partive Politike të regjistruar si subjekte zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme të datës 25 Prill 2021 morën pjesë në një takim prezantues të një Kodi Etik dhe një Udhëzuesi për Sjelljen, gjatë fushatës zgjedhore.

AKGJU njoftojë subjektet politike se do të kryejë një monitorim të mediave tradicionale dhe online për përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga subjektet zgjedhore në fushatë.

AKGJU vlerëson gatishmërinë e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse për qëndrimin pozitiv për nismën, përqafimin e saj dhe sidomos të dakordësisë njëzëri për domosdoshmërinë e këtyre instrumentave dhe kryerjes së një fushate zgjedhore në respekt të drejtave të njeriut, duke shmangur përdorimin e gjuhës së urrejtjes.

Trajnim i përbashkët me Zyrat Rajonale të Avokatit, KMD dhe Zyrat për Ndhmë Juridike Falas.



Me datë 26 mars u zhvillua online trajnimi i përbashkët me Zyrat Rajonale të Avokatit të Popullit, Zyrave Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Zyrat për Ndhmë Juridike Falas.

Qëllimi ishte diskutimi i praktikave për marrjen e ndërsjellët të ankesave mes ZRve dhe raste të veçanta për trajtim nga organet kompetente.

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi e konsideron bashkëpunimit me institucionet të tjera në terren shumë të rëndësishëm për evidentimin situatave Diskriminuese dhe bashkëveprimin për ti ndrequr, sipas ligjit.

KMD Gajda nderon largimin e parakohshëm nga jeta të Ligjvënësit Fino

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda u njoh me lajmin e ndarjes nga jeta të deputetit Bashkim Fino, ish kryeministër i qeverisë së Pajtimit Kombëtar.

Komisioneri Dr. Gajda ngushëllon familjen Fino, kolegët parlamentarë dhe miqtë e tij.

Z.Fino ishte një mbështetës i vendosur i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ngritjen e forcimin e Institucionit të KMD që garanton më shumë të drejta për qytetarët dhe promovon barazinë.

Z.Fino ishte një kampion i antidiskriminimit, përmes përdorimit të fjalës së urtë dhe instrumenteve të ligjvënësve, në mbrojtje të të drejtave të Njeriut. I paharruar qoftë kujtimi i tij.

"Në themel të të Drejtave të Njeriut: Institucionet Kombëtare Efektive të të Drejtave të Njeriut për Ballkanin Perëndimor"

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në Konferencën Rajonale "Në themel të të Drejtave të Njeriut: Institucionet Kombëtare Efektive të të Drejtave të Njeriut për Ballkanin Perëndimor", organizuar nga CIVIL RIGHTS DEFENDERS dhe Instituti Politikave Europiane.

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është renditur i pari në Shqipëri dhe i treti në rajon mes gjithë institucioneve për të drejtat e Njeriut, për efektshmërinë e veprimtarisë së tij, në katër komponentë:

- (1) Pavarësia dhe aftësia për të punuar pa presion,
- (2) Disponueshmëria e burimeve dhe kapaciteteve,
- (3) Informacioni, aksesueshmëria dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë të rëndësishëm,
- (4) Mandati dhe kompetencat.

Ky Raport është frut i monitorimit dhe vlerësimit që është bërë tërësisht nga organizatat ndërkombëtare të shoqërisë civile në rajon.

KMD mbi koordinimin institucional ndaj diskriminimit me bazë gjinore në punë



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në eventin mbi koordinimin institucional ndaj diskriminimit me bazë gjinore në punë si dhe për ndarjen e praktikës së mirë në Lezhë për reagim, të organizuar nga qendra Komunitare "Sot Per Te Ardhmen".

Në formatin tridimensional të tryezës, forumit dhe diskutimit online, u prezantuan gjetje dhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të ndërveprimit në një diskutim të gjerë me përfaqësues nga institucionet qendrore, rajonale dhe vendore, qeverisja qendrore dhe lokale, shoqëri civile, sektori privat dhe aktivistë/e të mbrojtjes së të drejtave në punë të grave dhe vajzave.

Komisioneri Dr. Gajda vuri në dukje rëndësinë e raportimit dhe trajtimit të çështjeve të diskriminimit gjinor në punë, respektimin e standardeve dhe promovimin e punës së denjë për gra dhe vajza.

KMD Gajda takim me znj. Lejdi Dervishi, Drejtor i Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në një takim znj. Lejdi Dervishi, Drejtor i Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE).

Komisioneri Dr. Gajda e informoi znj. Dervishi për veprimtarinë e KMD gjatë 2021 dhe angazhimin për të monitoruar edhe institucionet publike në raport me respektimin e të Drejtave të Njeriun.

Nga ana e saj, znj. Dervishi vlerësoi institucionin duke vënë në pah dëshirën për të bashkëpunuar në evidentimin dhe ndreqjen e situatave që prekin diskriminimin dhe stigmatizimin në shoqëri.

KMD Gajda në takimin kushtuar problematikave të autizmit në vend

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në një aktivitet kushtuar problematikave të autizmit në vend dhe nevojave për të garantuar shërbime cilësore edhe gjatë situatës së Pandemisë.

Një aspekt shumë i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve për këta persona është edhe institucioni i bashkisë. Për këtë arsye nënkryetari i Bashkisë së Elbasanit u shpreh se është shumë e rëndësishme veç koordinimit edhe takimi në mënyrë periodike me personat që kanë në familjet e tyre fëmijë me autizëm. Në vazhdimësi, në kuadër të objektivave institucionale për përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve/ qytetarëve, do të vijojnë të zhvillohen takime me tematika të tilla.

KMD Gajda reagon për ngjarjen e rëndë të ndodhur brenda xhamisë Dine Hoxha



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u njoh përmes medias me ngjarjen e rëndë të ndodhur brenda xhamisë Dine Hoxha, në Tiranë, me datë 19 prill, ku mbetën të plagosur 5 qytetarë.

Komisioneri Dr. Gajda dënon me ashpërsi agresionin dhe fton autoritetet hetimore të zbardhin sa më shpejt rrethanat e ngjarjes, duke vënë përpara përgjegjësisë ligjore autorin.

Urojmë shërim të shpejtë 5 qytetarëve të mbetur të plagosur. Në këto momente kërkohet njëherazi vetëpërmbajtje, gjykim i ftohtë dhe tolerancë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dëshiron për të gjithë komunitetin mysliman agjërim të lehtë e të pranuar, në këtë muaj të bekuar.

KMD Gajda deklaratë për incidentin politik në Divjakë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoroi me shqetësim gjithë fushatën elektorale dhe regjistroi të gjitha rastet e dhunës verbale e fizike.

Edhe në ditën e përcaktuar si heshtje zgjedhore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u njoh nëpërmjet mediave me incidentin e Divjakës, në të cilën një aktiviste politike u dhunua fizikisht dhe verbalisht.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nxit Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë të zbardhë sa më shpejt ngjarjen e papranueshme të ushtrimit të dhunës ndaj një gruaje, por edhe për shkak të bindjeve politike, si dhe të merren masa të menjëhershme ndaj autorit.

Institucioni i KMD garanton qytetarët se do të monitorojë dhe nxisë institucionet të zbatojnë ligjet sa herë konstaton shkelje të të drejtave të Njeriut.

KMD Gajda takim z. Sead Kazanxhiu, Nënkyetar i Komitetit të Pakicave (Rome)

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në një takim z. Sead Kazanxhiu, Nënkyetar i Komitetit të Pakicave në Republikën e Shqipërisë, si përfaqësues i pakicës rome.

Biseda u përqendrua në bashkëpunimin e ndërsjellë për të adresuar sfida të pakicave



Faleminderit për përkushtimin dhe sakrificën!
Faleminderit mjekëve dhe infermierëve,
punëtorëve të shëndetësisë, heronjve të
vërtetë që plot kurajo qëndrojnë në vijën e parë
të kësaj emergjence shëndetësore botërore.

Zyra e Komisionerit për mbrojtjen nga
Diskriminimi shpreh admirim për devotshmërinë
në punën e përditshme dhe nxit qytetarët të
jenë më të vëmendshëm në respektimin e
distancës fizike, higjenës personale dhe
mbajtjes së maskës në ambiente të mbyllura.





Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kreu i KMD:

Z. Robert Gajda

Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucion i pavarur i Republikës së Shqipërisë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ai mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), e cila ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010.

Për informacione të mëtejshme mbi aktivitetet:

www.kmd.al

Zyra qendrore e KMD

Rr: Rruga e Durrësit (Ish Ministria e Mjedisit)
Tirana, Albania

Zip Code: 1001

E-mail: info@kmd.al

Tel:

Komisioneri: + 355 4 243 1077

Ankesa: + 355 4 243 1078

Zyra rajonale:

Shkodër: Pranë Bashkisë Shkodër, Rr.13 Dhjetori, Nr.1

Zip Code: 4001

Tel: + 355 4 243 1078

Korçë: Pranë Bashkisë Korçë Rr:28 Nentori Nr.1

Zip Code: 7001

Tel: + 355 4 243 1078

FIER: Pranë ADISA , Lagjia 11 Janari, “Shtëpia e Ushtarakëve”

Zip Code: 9301

Tel: + 355 4 243 1078